

Siguria dhe shëndeti në punë janë shqetësim i secilit. Ato janë të mira për ju. Janë të mira për punën.

Vende Pune të Shëndetshme **LEHTËSO NGARKESËN**



#EUhealthyworkplaces

www.healthy-workplaces.eu

Çmimet e Praktikave të Mira për Vende Pune të Shëndetshme

Thirrje për nominime



Menaxhimi i çrregullimeve muskulo-skeletore në punë

Çrregullimet muskulo-skeletore (ÇMS-të) janë problemi shëndetësor më i përhapur në Evropë, i shkaktuar nga puna dhe janë ndër shkaqet më të shpeshta të aftësisë së kufizuar, marrjes së raportit mjekësor për shkak të sëmundjes dhe daljes në pension të parakohshëm. Për pasojë, ato jo vetëm që ulin cilësinë e jetës së punëtorëve, por janë gjithashtu shumë të dëmshme për bizneset dhe ekonominë kombëtare. Prandaj, ky problem duhet të adresohet për të përmirësuar shëndetin dhe mirëqenien e punëtorëve, për t'i bërë kompanitë më konkurruese dhe për të zvogëluar barrën për sistemet kombëtare të shëndetësisë.

Kjo fushatë ka si synim të ndërgjegjësojë lidhur me ÇMS-të e shkaktuara nga puna dhe rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet punëdhënësve, menaxherëve dhe punonjësve, për t'i parandaluar dhe menaxhuar ato. Ajo synon të ndihmojë kompanitë t'i trajtojnë ÇMS-të në mënyrë sistematike, duke ofruar këshilla praktike dhe udhëzime për shembuj të praktikave të mira dhe raste studimore, së bashku me materiale dhe burime të tjera informuese.

Fushata për Vende Pune të Shëndetshme 2020-2022 ka objektivat e mëposhtme:

1. të ndërgjegjësojë mbi rëndësinë e parandalimit të ÇMS-ve të lidhura me punën, duke ofruar fakte dhe shifra mbi ekspozimin ndaj ÇMS-ve dhe ndikimin e tyre.
2. të promovojë vlerësimin e rreziqut dhe menaxhimin proaktiv të ÇMS-ve duke siguruar akses në burimet për ÇMS-të, si mjete, materiale udhëzuese dhe ato audio-vizuale;
3. të përmirësojë njohuritë mbi rreziqet e reja dhe që ato po shfaqen, si dhe zhvillime të tjera në lidhje me ÇMS-të e shkaktuara nga puna;

4. të ndërgjegjësojë për rëndësinë e riintegritit dhe mbajtjes në punë të punonjësve me ÇMS-të kronike dhe si mund të bëhet kjo në praktikë;
5. të mobilizojë dhe nxisi bashkëpunimin efikas ndërmjet palëve të interesit duke i bërë ata bashkë dhe duke
6. lehtësuar shkëmbimin e informacionit, njohurive dhe praktikave të mira.

Mund të gjeni më shumë informacion për fushatën në www.healthy-workplaces.eu

Çrregullimet muskulo-skeletore janë problemi shëndetësor më i përhapur në Evropë, i shkaktuar nga puna.



Çmimet e Praktikave të Mira për Vende Pune të Shëndetshme

Agjencia Evropiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (EU-OSHA), së bashku me vendet anëtare, organizon aktivitetin e **Çmimeve të Praktikave të Mira për Vende Pune të Shëndetshme** krahas Fushatave të saj për Vende Pune të Shëndetshme . Çmimet janë për të treguar përfitimet e sigurisë dhe shëndetit të mirë në vendin e punës dhe shërbejnë si **platformë për të ndarë dhe promovuar praktika të mira në të gjithë Evropën.**

Qëllimi specifik i aktivitetit të Çmimeve të Praktikave të Mira për Vende Pune të Shëndetshme është të nxjerrë në pah shembujt më të mirë dhe organizatat lider që **kanë parandaluar dhe menaxhuar në mënyrë aktive ÇMS-të në vendin e punës**. EU-OSHA po kërkon për shembuj që pasqyrojnë **qasje gjithëpërfshirëse** ndaj menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit (SSHP), ku **edhe punëdhënësit edhe punëmarrësit angazhohen të punojnë së bashku për të parandaluar ÇMS-të.**

Juria gjithashtu po kërkon për ndërhyrje që janë edhe **të qëndrueshme edhe të transferueshme.**

EU-OSHA mirëpret pjesëmarrës të rinj nga të gjitha organizatat dhe individët e interesuar nga e gjithë Evropa dhe nga ndërmjetësit si partnerë socialë, praktikantë dhe profesionistë të sigurisë dhe shëndetit, dhe këshilltarë të SSHP-së në nivel vendi pune.

Fituesit do të shpallen në prill të vitit 2022 dhe do të marrin çmimet e tyre në një ceremoni të mëvonshme gjatë këtij viti. Gjithashtu do të kremtohen arritjet e të gjitha organizatave që kanë marrë pjesë. Detajet e të gjithë shembujve të vlerësuar me çmime do të promovohen gjerësisht në të gjithë Evropën dhe do të publikohen në faqen e internetit të EU-OSHA.



Cilat lloje të praktikave të mira mund të marrin pjesë?

Të gjithë **shembujt e jetës reale të qasjeve risiprurëse dhe efikase të menaxhimit të SSHP-së për parandalimin e ÇMS-ve** janë të pranueshëm. Pjesëmarrësit duhet të përshkruajnë qartë se si janë zbatuar në vendin e punës praktikatat e mira të menaxhimit dhe çfarë është arritur, duke përfshirë aspektet si:

- si u organizua në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe efektive vlerësimi i rrezikut, duke mbuluar të gjitha rreziqet përkatëse për të gjithë grupet e punëtorëve;
- mënyra në të cilën u pasua hierarkia e parandalimit;
- si u eliminuan rreziqet e ÇMS-ve nga zgjidhjet e projektimit ('projektimi

ergonomik'); shembuj të projektimit të vendit të punës, projektimit të pajisjeve të punës, proceseve, etj., inkurajohen në mënyrë të veçantë;

- mënyrat në të cilat u bë ndërgjegjësimi dhe u inkurajua kultura e parandalimit;
- si u zbatuan masat mbështetëse, të tilla si përshtatje / përmirësime në vendin e punës, për të siguruar që një punëtor që vuan nga një ÇMS mund të vazhdojë punën ose arriti të kthehet në punë. ÇMS-i mund të jetë ose jo i shkaktuar nga puna.

Adresimi i ÇMS-ve do të përmirësojë shëndetin dhe mirëqenien e punëtorëve, do t'i bëjë kompanitë më konkurruese dhe do të zvogëlojë barrën e sistemeve kombëtare të shëndetësisë.

Çfarë duhet të tregojë një pjesëmarrës i ri?

Juria trepalëshe do të kërkojë prova të:

- qasjes gjithëpërfshirëse për sigurinë dhe shëndetin në punë;
- përmirësimeve të vërteta dhe të dukshme për sigurinë dhe shëndetin në lidhje me ÇMS-të e shkaktuara nga puna;
- përparësisë së masave kolektive ndaj ndërhyrjeve që përqendrohen te individit;
- pjesëmarrjen efektive dhe përfshirjen e punëtorëve dhe përfaqësuesve të tyre;
- qëndrueshmërinë e ndërhyrjes me kalimin e kohës;
- transfueshmërinë në vendet e tjera të punës (në shtetet e tjera anëtare, në sektorë të ndryshëm dhe me përmasa të ndryshme);
- aspektit kohor (ndërhyrja duhet të jetë e kohëve të fundit ose nuk

do të reklamohet gjerësisht).

Për më tepër, ndërhyrja duhet të përmbushë, dhe idealisht të tejkalojë, kërkesat legjislative përkatëse të shtetit anëtar në të cilin është zbatuar. Produktet, mjetet dhe shërbimet e zhvilluara për qëllime komerciale nuk do të merren parasysh në konkurs.

Vizitoni faqen e internetit – <https://healthy-workplaces.eu/en/get-involved/good-practice-awards> – për shembuj të praktikave të mira që kanë marrë çmime në vitet e kaluara.

ÇMS-të janë një problematikë për të gjithë në të gjithë llojet e vendeve të punës në të gjithë sektorët dhe mund të trajtohen në mënyrë të suksesshme.



Kush mund të marrë pjesë?

Aplikimet e reja për praktikatat e mira mund të dorëzohen për në konkurim nga të gjitha organizatat aktive në vendet anëtare të BE-së, vendet kandidate dhe vendet e mundshme kandidate, si dhe anëtarë të Shoqatës Evropiane për Tregtinë e Lirë (EFTA), duke përfshirë:

- sipërmarrjet individuale dhe organizatat e të gjitha përmasave;
- ofruesit e trajnimit dhe anëtarët e komunitetit të arsimit;
- organizatat e punëdhënësve, shoqëritë tregtare, sindikatat dhe organizatat jofitimprurëse;
- shërbimet rajonale ose vendore të parandalimit të SSHP-së, shërbimet e sigurimeve dhe organizatat e tjera ndërmjetëse.

Si të merrni pjesë?

Të gjithë pjesëmarrësit e rinj gjykohen fillimisht në nivelin kombëtar nga rrjeti i pikave fokale të EU-OSHA. Më pas, fituesit kombëtar marrin pjesë në konkursin pan-Evropian, pas së cilit, zgjidhen fituesit e përgjithshëm.

Partneri i rrjetit në vendin tuaj mund t'ju ofrojë detaje se si të merrni pjesë në konkurs. Vizitoni <https://healthy-workplaces.eu/en/get-involved/good-practice-awards> për të zbuluar se si të kontaktoni me pikën tuaj fokale kombëtare dhe të kontrolloni afatet kombëtare.

***Ndiqui fushatën në rrjetet sociale:
#EUhealthyworkplaces***



Agjencia Evropiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (EU-OSHA) ju fton në Edicionin e 15-të të **Çmimeve të Praktikave të Mira për Vende Pune të Shëndetshme lidhur me Sigurinë dhe Shëndetin në Punë**. Si pjesë e fushatës 2020-2022, "Vende Pune të Shëndetshme Lehtëso Ngarkesën", fushata synon të vlerësojë organizatat që po japin kontribut të jashtëzakonshëm dhe risiprurës në sigurinë dhe shëndetin, duke parandaluar çrregullimet muskulo-skeletore në vendin e punës.

Agjencia Evropiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (EU-OSHA) është një agjenci që kontribuon për ta bërë Evropën një vend më të sigurt, më të shëndetshëm dhe më produktiv për të punuar. E krijuar nga Bashkimi Evropian që prej vitit 1994, me qendër në Bilbao, Spanjë, Agjencia hulumton, zhvillon dhe shpërndan informacion të besueshëm, objektiv dhe të paanshëm lidhur me sigurinë dhe shëndetin, duke krijuar rrjete me organizata të tjera në të gjithë Evropën, me qëllim përmirësimin e kushteve të punës.

Gjithashtu, EU-OSHA drejton **Fushatat për Vende Pune të Shëndetshme**, të mbështetura nga institucionet e BE-së dhe partnerët socialë evropianë dhe koordinohen në nivel kombëtar nga rrjeti i pikave fokale të Agjencisë. Fushata e viteve 2020-22, **“Vende Pune të Shëndetshme Lehtëso Ngarkesën”** synon të ndërgjegjësojë mbi ÇMS-të të shkaktuara nga puna dhe mbi nevojën e menaxhimit të tyre dhe promovimit të një kulture të parandalimit të rrezikut.

Agjencia Evropiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë

C/Santiago de Compostela 12

48003 Bilbao, SPAIN

Email: information@osha.europa.eu

www.healthy-workplaces.eu

© Agjencia Evropiane për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, 2020. Lejohet shumëfishimi me kusht që të përcaktohet burimi.

Për shumëfishim ose përdorim të ndonjë fotografie me të drejtë autori tjetër përveç të EU-OSHA, leja duhet t'i kërket direkt mbajtësit të të drejtave të autorit.

Fotografitë e përdorura në këtë botim ilustrjnë një sërë veprimtarish pune. Ato nuk paraqesin medoemos praktika të mira apo zbatueshmërinë e kërkesave legjislative.

